



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.443/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Faton Bajrami në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Dogana e Kosovës, kundër debitorit NTP “Tafaj&Co” me seli në Gelanc-Suharekë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, P.nr.501/2021 i datës 28.02.2022, me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit NTP “Tafaj&Co” me seli në Gelanc-Suharekë ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, P.nr.501/2021 i datës 28.02.2022, **PRISHET** dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale, dhomave të shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, me aktvendimin e atakuar, P.nr.501/2021 i datës 28.02.2022 në dispozitivin e aktvendimit ka refuzuar prapësimin e debitorit NTP “Tafaj&Co”, dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.181/2019 të datës 27.08.2019.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori NTP “Tafaj&Co” me propozimin që aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, P.nr.501/2021 i datës 28.02.2022, ta anulohet dhe që Urdhrin e Përmbaruesit Privat të anulohet dhe propozimin për përmbarim ta refuzojë si të pa bazuar.

Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën

Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbartimor-Aktvendimi i Doganës së Kosovës-Sektorit për Kundërvajtje Dogonore nr.03.1.7-2019-690/2, i datës 26.04.2019. Përmbartuesi privat, ka lejuar përmbartimin me urdhrin përmbartimor P.nr.181/19 të datës 27.08.2019.

Kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim nëpërmjet të cilit ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetimin se aktvendimi i Doganës nuk mund të jetë vendim i plotfuqishëm e as i ekzekutueshëm sepse debitori ka parashtruar ankesë në Sektorin për Rishqyrtimin e Vendimeve të Doganës së Kosovës me datën 25.04.2019, e që kjo bie në kundërshtim me nenin 130 par.1 të LPPA-së me të cilin përcaktohet se ankesa e pezullon e aktin. Ka shtuar se aktvendimi i lartcekur është lëshuar me datën 26.04.2019 ndërsa është bërë i plotfuqishëm me datën 08.04.2019 ndërsa i ekzekutueshëm më datën 08.05.2019 e që kjo mospërputhje e datave është e pamundur.

Kreditore ka ushtruar përgjigje në prapësim nëpërmjet të cilës ka theksuar se është lëshuar një gabim teknik sa i përket datës së plotfuqishmërisë dhe asaj të ekzekutueshmërisë andaj, propozimi për përmbartim i plotëson kushtet e parapara dhe si i tillë është i përshtatshëm për përmbartim ndaj debitorit.

Gjykata Themelore në Prizren-Dega e Gjykatës në Suharekë me aktvendimin PP.nr.190/2019 e datës 26.04.2019 ka aprovuar prapësimin e debitorit NTP "Tafaj&Co", dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor, P.nr.181/2019 të datës 27.08.2019.

Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë me Aktvendimin Ac.nr.920/2020 të datës 20.05.2020 ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit dhe ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren-Dega e Gjykatës në Suharekë me aktvendimin PP.nr.190/2019 e datës 26.04.2019 dhe e ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Tutje, Gjykata Themelore në Prizren-Dega e Gjykatës në Suharekë pas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, me aktvendimin PP.nr.190/2019 e datës 14.09.2020 ka refuzuar prapësimin e

debitorit NTP “Tafaj&Co”, dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.181/2019 të datës 27.08.2019.

Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë me Aktvendimin Ac.nr.4702/2020 të datës 28.07.2021 ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit dhe ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren-Dega e Gjykatës në Suharekë me aktvendimin PP.nr.190/2019 e datës 14.09.2020 dhe e ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Themelore në Prizren-Dega e Gjykatës në Suharekë, pas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, me aktvendimin P.nr.501/2021 e datës 28.02.2022 ka refuzuar prapësimin e debitorit NTP “Tafaj&Co”, dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.181/2019 të datës 27.08.2019. Në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se dokumenti përmbartimor i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 22 par 1 pika 1.2 lidhur me nenin 23 par 2 të LPP-së

Gjykata Komerciale vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika n), neni 183 të LPK-së, lidhur me nenin 22 par 1 pika 1.2 të LPP-së.

Aktvendimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet meqë dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten si dhe me arsyetimin e aktvendimit. Në aktvendimin e atakuar ekzistojnë fakte vendimtare në kundërtënie midis asaj që në dispozitiv të aktvendimit thuhet për përmbajtje të dokumentit.

Gjykata Komerciale -- Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar saktë shkresat e lëndës si dhe nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike kur ka refuzuar prapësimin e debitorit me arsyet se urdhri për përmbartim është lejuar mbi bazën e dokumentit përmbartimor-Aktvendimi i Doganës së Kosovës-Sektorit për Kundërvajtje Doganore nr.03.1.7-2019-690/2, i datës 26.04.2019 i cili vendim përmban vulën e plotfuqishmërisë me datën 17.06.2021 dhe vulën e plotfuqishmërisë me datën 17.07.2021, ndërsa gjykata e shkallës së parë ka anashkaluar dhe nuk ka vlerësuar provën- Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.2073/19 dt.08.04.2019. Gjykata e Shkallës së parë ka anashkaluar këtë provë dhe nuk e ka vlerësuar fare përderisa nga kjo provë do të kishte bazë për vendosjen ndryshe.

Andaj, duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”*, Gjykata e shkallës së parë është dashur që ta ketë parasysh aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.2073/19 dt.08.04.2019 më të cilin është anuluar Aktvendimi i Doganës së Kosovës-Sektori për Kundërvajtje Dogonore nr.01.3.2.2/6535 dt.15.09.2019.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë është dashur të vlerësoj dokumentin përmbarimor nëse i plotëson kushtet e përcaktuara me dispozitat e LPP, për zbatimin e përmbarimit andaj, edhe nga këto arsye është dashur që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja ti kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura, ashtu që të vlerëson në mënyrë të drejtë dokumentin përmbarimor nëse i njëjti sipas dispozitave ligjore i plotëson kushtet si dokument përmbarues, e pas kësaj të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm konform dispozitave të LPP-së.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkalles se Dytë

K.DH.SH.II nr.443/23 me datë 05.03.2024

Gjyqtari

Faton Bajrami